



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punës dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 73

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

Prishtinë, më 24 Qershor 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Bahri Thaçi, Salihe Mustafa, Gezim Kelmendi, Nazane Breca, Liburn Aliu

Munguan: Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 05.06.2013**
- 3. Diskutimi i shkresës së ministrit të shëndetësisë për Projektligjin për transplantimin e organeve**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës
Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 05.06.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin nga mbledhja e datës 05.06.2013

3. Diskutimi i shkresës së ministrit të shëndetësisë Shqyrtimi për Projektligjin për transplantimin e organeve.

Fikrim Damka – Sot do të diskutojmë për shkresën e ministrit të shëndetësisë për tërheqjen e projektligjit për transplantimin e organeve, ku në mbështetje të nenit 56, paragrafi 5, të rregullores së punës së Kuvendit, ka të drejt ta tërheq Projektligjin deri në procesin e votimit në lexim të dytë. Hap debatin .

Time Kadrijaj- Tha se ministri ka të drejtë në tërheqjen e projektligjit, por mendoj se tërheqja e projektligjit për transplantimin e organeve do të duhej të shoqërohej me një arsyetim. Ne kemi punuar gjatë dhe me kujdes dhe nuk kemi pasur ndonjë problem, gjithashtu edhe vërejtjet e Zyrës së BE-së në Kosovë për lejimin e transplantimit vetëm në sektorin publikë i kemi bërë me kohë, andaj më duket e pakuptimtë tërheqja e projektligjit në këtë fazë.

Nazane Breca- Tha se kjo shkresë ka ardhur shumë me vonesë, sepse ne e kemi kryer shqyrtimin, dhe nuk është e drejte sepse ne i kemi inkuorporuar të gjitha ndryshimet që kemi menduar se janë të rëndësishme të inkuorporohen. Mendoj se duhet të bisedojmë me ministrin edhe për Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave, sepse gjatë punës tonë kemi vërejtur se këto dy projektligje nuk janë koordinuar. Është mirë që të ekzistoj vetëm një qendër e përbashkët e transplantimit për të dy ligjet . Ndoshta duhet të tërheqjet edhe Projektligji për transplantimin e indeve dhe qelizave dhe të koordinohen të dy projektligjet .

Liburn Aliu- Tha se ministri ka të drejtë në tërheqjen e projektligjit. Më i rëndësishme është tash projektligji për transplantimin e indeve dhe qelizave.

Salihe Mustafa- Tha, ne duhet t'a ftojme ministrin dhe t'a pyesim përse këto dy projektligje nuk janë koordinuar. Unë nuk jam për ndërprerjen e punës në projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave sepse ka shume nevojë për këtë projektligj. Mendoj që duhet t'a ftojme ministrin zyrtarisht në komision që të bisedojmë lidhur me këto çështje.

Bahri Thaqi-Tha se gjatë shqyrtimit të Projektligjit për transplantimin e organeve janë paraqitur edhe disa vërejtje për të cilat edhe ne si Komision kemi pasur dilema nëse duhet të implementohen apo jo. Andaj konsideroj që ministri ka bërë një punë shumë të mirë me tërheqjen e projektligjit duke na dhënë mundësin që në një momentin më të volitshëm përsëri me pak punë t'a bëjmë një ligj të mirë dhe shumë funksional.

Flora Brovina- Tha se nëse propozuesi konstaton që projektligji duhet të tërhiqet, atëherë ai ka të drejtë.

Nazane Breca- Tha se nuk e kontestojmë a ka te drejtë apo jo, por reagimi i ministrit ka ardhur me shumë vonesë. Mendoj që Projektligji për transplantimin e indeve dhe qelizave duhet të koordinohet me Projektligjin për transplantimin e organeve, në mënyrë që të dalin dy projektligje të mira dhe të implementueshme edhe pse do vonohen pak.

Time Kadrijaj- Tha se patjetër këto dy projektligje duhet të harmonizohen.

Salihe Mustafa- Tha se duhet të vazhdojmë të punojmë në Projektligjin për indet dhe qelizat sepse ka shumë nevojë për të, por paraprakisht propozoi t'a ftojme ministrinë dhe të bisedojmë.

Fikrim Damka- Tha se me propozimin tuaj do ta ftojme ministrin në komision dhe te diskutojmë për Projektligjin që është tërhequr , edhe për Projektligjin që e kemi në procedurë. Gjithashtu do të diskutojmë edhe për shkresën e ministrit të shëndetësisë për mbështetje të kërkesës së tyre të drejtuar Komisionit të Buxhetit, për rishikimin e buxhetit në pjesën e shëndetësisë.

4. Të ndryshme

Grupit punues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr 04/l-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre të vazhdoj punën .

Gjithashtu u vendos të vazhdojë puna në monitorimin e Ligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka